



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Olimpiada e Historisë

Faza II

Viti shkollor 2014 – 2015

Klasa 11 Skema e vlerësimit

15 prill 2015

Pyetja 1. Perandoria romake u nda në dy pjesë në vitin 395. Ndarja e saj u shoqërua me ndryshime edhe në aspektin fetar. Shkruani katër ndryshime në besimin fetar midis Perandorisë Romake të Lindjes dhe Perandorisë Romake të Perëndimit. **8 pikë**

Perandoria Romake e Perëndimit	Perandoria Romake e Lindjes
- Gjuha latine	- Gjuha greke
- Kreu i kishës ishte Papa	- Kreu i kishës ishte Patriarku
- Papa kurorëzonte mbretin dhe luante rol kryesor në zgjedhjen e tij	- Peshkopët dhe priftërinjtë zgjidheshin prej perandorëve
- Qendra e kishës ishte në Romë.	- Qendra e kishës ishte në Kostandinopojë
- Besimi katolik	- Besimi ortodoks
- Kalendari i ndryshëm fetar	- Kalendari i ndryshëm fetar
- Priftërinjtë nuk martoheshin	- Priftërinjtë martoheshin (nuk bëjnë karrierë)
- Ceremonitë e ndryshme fetare	- Ceremonitë e ndryshme fetare
- Hierarkia e ndryshme fetare	- Hierarkia e ndryshme fetare

Nxënësi fiton:

8 pikë nëse shkruan 4 ndryshime për secilën prej tyre.

6 pikë nëse shkruan 3 ndryshime për secilën prej tyre

4 pikë nëse shkruan 2 ndryshime për secilën prej tyre

2 pikë nëse shkruan 1 ndryshim për secilën prej tyre

Nxënësi nuk fiton pikë nëse shkruan vetëm për njërin nga perandoritë.

Pyetja 2. Athina ishte djepi i lindjes së demokracisë në antikitet. Përfaqësuesi kryesor i demokracisë në Athinë ishte Perikliu.

- a) Krahasoni demokracinë athinase para qeverisjes së Perikliut dhe pas qeverisjes së tij. Evidentoni tre ndryshime midis tyre. **8 pikë**

Demokracia athinase para Perikliut	Demokracia athinase pas Perikliut
- Në institucione merrnin pjesë vetëm shtresat e larta të popullsisë	- Për herë të parë gjatë qeverisjes së Perikliut u vendosën pagesat nga shteti për njerëzit që punonin në institucione.
- Njerëzit e varfër nuk kishin mundësi monetare për të marrë pjesë në shfaqje të ndryshme	- U krijua një fond i veçantë për tu mundësuar njerëzve të thjeshtë pjesëmarrje nëpër teatro.
- Funkcionin formalisht gjyqi i Popullit, këshilli i të 400-ëve etj	- Krijoi këshillin e 10 Strategëve si një organ mbështetës për demokracinë që ai kishte në plan të aplikonte

- E drejta e fjalës dhe e mendimit ishte më e kufizuar	- U zgjerua e drejta e fjalës dhe e mendimit nëpërmjet ligjit grafe paranamon (shkruar sipas të drejtës që të jep ligji)
--	--

Nxënësi fiton:

8 pikë nëse shkruan 4 ndryshime për secilën prej tyre.

6 pikë nëse shkruan 3 ndryshime për secilën prej tyre

4 pikë nëse shkruan 2 ndryshime për secilën prej tyre

2 pikë nëse shkruan 1 ndryshim për secilën prej tyre

Nxënësi nuk fiton pikë nëse shkruan vetëm për njërin nga periudhat.

- b) Pavarësisht arritjeve të Perikliut lidhur me demokracinë athinase, ajo prapë ishte e kufizuar. Shpjegoni shkurtimisht pse demokracia athinase ishte e kufizuar. **2pikë**

Përgjigje:

Ishte demokraci e kufizuar sepse qytetarë me të drejta politike quheshin një pjesë shumë vogël e popullsisë: qytetarët e Athinës; qytetarët e lirë dhe banorë të Athinës (nga nëna dhe babai). Të tjerët jo qytetarë ishin të huajt, skllëvërit dhe gratë të cilët nuk kishin të drejta politike.

Në mbledhjet e Eklesisë (Kuvendi i qytetarëve) merrnin pjesë vetëm shtresat e pasura.

Gratë nuk kishin të drejtë të votonin.

Ekzistenca e skllavërisë shihej si një fenomen i natyrshëm.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse jep dy nga argumentet e mësipërm

1 pikë nëse jep një nga argumentet e mësipërm

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 3. Evidentoni dy nga elementet e përbashkëta mes Perandorisë Osmane dhe asaj Habsburge. **2 pikë**

- Te dy perandoritë sundonin popuj me kombësi të ndryshme;
- Forma qeverisjes ishte autokratike.
- Synimi ishte zgjerimi i territoreve.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy nga elementët e mësipërm

1 pikë nëse shkruan një nga elementët e mësipërm

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 4. Reformacioni ishte një nga lëvizjet më të rëndësishme për reformimin e kishës në Evropë.

- a) Identifikoni ideatorin dhe tre nga shkaqet e lindjes së reformacionit? **4 pikë**

Martin Luter

Lindi si nevojë për reformimin e kishës katolike

- Prapambetja e kishës katolike, paaftësia e saj për të zgjidhur problemet shoqërore
- Korrupsioni që ekzistonte në kishën katolike/ shitja e indulgjencave
- Inkuizicioni – gjyqet kishtarë të cilat kishin vetëm një qëllim – bindjen ndaj papës
- Jeta luksoze që bënin murgjit dhe murgeshat, duke u larguar nga hallet e popullit
- Shpenzimet e mëdha për organizimin e ceremonive fetare
- Shitja e posteve fetare, që kishte çuar në rënien e nivelit intelektual të priftërinjve

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse identifikon ideatorin dhe 3 nga shkaqet e lindjes së reformacionit.

- Nëse nxënësi nuk identifikon ideatorin i ulet një pikë
- Për çdo shkak që nuk shkruan i ulet një pikë.

b) Evidentoni dy nga pasojat e reformationit në Evropë. 2 pikë

- U kufizua pushteti kishtar
- Dobësimi i unitetit fetar në Evropë, pasi të krishterët u ndanë në katolikë dhe protestantë
- Në ato rajone ku u përqaftua protestantizmi ekonomia eci më përpara se në vendet që i mbetën fanatik katolicizmit.
- Zhvillimi i arsimit

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse identifikon dy nga pasojat

1 pikë nëse identifikon një nga pasojat

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

c) Përse u mbledh Koncili i Trentos? 1 pikë

Përgjigjja:

Për të forcuar pozitën e kishës katolike.

Për t'iu kundërvënë reformationit.

Nxënësi fiton:

1 pikë nëse shkruan një nga arsyet e mësipërme

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

d) Listoni tre nga vendimet e Koncilit të Trentos 3 pikë

- Vetëm kisha mund të bënte shpjegimin dhe interpretimin e Biblës
- Besimi dhe punët e mira janë domosdoshmëri për shpëtimin e njeriut
- Rituale të kishës janë elementi thelbësor i besimit katolik
- Shërbimet fetare të kryhen në latinisht
- Papa është autoriteti më i lartë i kishës katolike
- Klerikët duhet të ishin të disiplinuar të jetonin thjeshtë, larg luksit dhe pasurisë
- Hapja e seminareve për rritjen e nivelit të priftërinjve
- Pranimi i celibatit (beqaria e klerikëve)

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse liston tre nga vendimet

2 pikë nëse liston dy nga vendimet

1 pikë nëse liston një nga vendimet

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 5. Shpjegoni pretekstin dhe shkaqet reale të pikënisjes së konfliktit midis kolonistëve dhe britanikëve.

3 pikë

Preteksti i nisjes së konfliktit u bë vendosja e taksës së pullës. Taksa si vlerë nuk ishte e madhe por ajo i revoltoi kolonistët, të cilët kishin bindje se nuk mund të detyroheshin nga parlamenti britanik të paguanin taksa ngaqë ata nuk kishin përfaqësues të tyre në atë parlament. Për këtë arsye taksën e pullës e quajtën taksë pa përfaqësim. Ndërsa shkaqet reale gjendeshin tjetërkund. Ishin kërkesat e kolonive për shpëtimin nga Britania. Tashmë kolonitë ishin forcuar, konsoliduar dhe mund të ecnin përpara të pavarura nga Britania.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shpjegon taksën e pullës dhe shkaqet reale

2 pikë nëse shpjegon vetëm taksën e pullës OSE vetëm shkaqet reale

1 pikë nëse thjeshtë përmend taksën e pullës OSE shkaqet reale

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 6. Përcaktoni një nga pasojat e veprimtarisë së regjimeve totalitare të djathta në secilin prej aspekteve të mëposhtme:

- a) Politik-Institucional 1 pikë
- b) Ekonomik 1 pikë
- c) Social 1 pikë

Përgjigje:

- a) Regjimet totalitare shkatërruan institucionet demokratike liberale. Ekzistenca e një partie politike. U mohua vota e lirë. Organi legjislativ (parlamenti) nuk funksionoi.
- b) Në fushën ekonomike, këto regjime vendosën kontrollin e shtetit mbi prodhimin dhe shpërndarjen.
- c) U shtypën liritë dhe të drejtat themelore e si rezultat miliona njerëz që mendonin ndryshe u persekutuan u vranë u shfrytëzuan.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse përcakton një nga pasojat e të tri pikave

2 pikë nëse përcakton një nga pasojat e dy pikave

1 pikë nëse përcakton një nga pasojat e njëjës prej pikave

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 7. Baza ideologjike e Revolucionit Borgjez Francez u frymëzua nga idetë e Iluminizmit.

- a) Cilat ishin dy aktet e para të periudhës së Revolucionit ku u materializuan idetë më të rëndësishme të iluministëve (Gusht 1789)? **2 pikë**

Përgjigja:

- Heqja e bujkrobërisë dhe shpallja e fundit të feudalizmit në Francë.
- Miratimi i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy aktet e para ku u materializuan idetë iluministe

1 pikë nëse shkruan një nga aktet e para ku u materializuan idetë iluministe

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

- b) Cilat ishin dy nga risitë më të rëndësishme të bazuara në idetë iluministe në kushtetutën e vitit 1791? **2pikë**

Përgjigja:

- Ndarja e pushteteve në ekzekutiv (mbreti), legjislativ (asambleja legjislative) dhe gjyqësor (të zgjedhur te pavarur).
- Shpallja e formës së regjimit si monarki kushtetuese.
- Vendosja e parimit të sovranitetit popullor.
- Te drejtat e njeriut (burrave)

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy risitë më të rëndësishme bazuar në idetë iluministe

1 pikë nëse shkruan një nga risitë më të rëndësishme bazuar në idetë iluministe

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

- c) Evidentoni dy ndryshimet e sanksionuara në kushtetutën e vitit 1793 krahasuar me atë të vitit 1791? **2 pikë**

Përgjigja:

- E drejta universale e votës për burrat në moshë madhore.
- Ndryshimi i formës së regjimit nga monarki kushtetuese në republikë.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy ndryshimet e kushtetutës

1 pikë nëse shkruan një nga ndryshimet e kushtetutës
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 8. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që mbështesin tezat tuaja dhe një përfundim. **8 pikë**

Tema: Nacionalizmi

Nacionalizmi ka ndikuar në ngjarjet botërore në 500 vitet e fundit. Dëshira për të vetëqeverisur ka ndikuar pozitivisht dhe negativisht. Individët kanë luajtur rol të rëndësishëm në udhëheqjet e lëvizjeve nacionaliste, të cilat kanë pasur ndikim të fuqishëm në vende dhe kombe të ndryshëm.

Zgjidhni një lider nacionalist dhe:

- Identifikoni vendin apo rajonin ku ai ka udhëhequr një lëvizje nacionaliste
 - Përshkruani sfondin historik ku ndodhi lëvizja nacionaliste
 - Analizoni se si veprimtaria e atij lideri nacionalist ka influencuar në vendin ku kjo lëvizje u zhvillua.
- Disa liderë nacionalistë të cilët ju mund t'i merrni në konsideratë janë: Henri VIII, Elisabeta I, Fidel Kastro, Xhuzepe Garibaldi, Oto Von Bismark, Nelson Mandela, Mahandas Gandi, Mustafa Kemal Atatürk.

Ju nuk jeni të kufizuar në këto shembuj. Mund të zgjidhni një lider në bazë të njohurive që keni.

Kriteret e vlerësimit të esesë historike

Kriteri I: Organizimi dhe struktura e esesë **2 pikë**

Struktura e esesë respekton këto elementë:

- hyrjen; - zhvillimin; - përfundimin. Nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës. – **1 pikë**
- Organizimi i esesë - ka një organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri). - **1 pikë**

Kriteri II: Analiza **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi: shkruan një ese, ku argumenton idetë e tij për temën e dhënë;

- mban qartë një pozicion të dukshëm në argumentet e dhëna; ka qartësi mendimi. - **1 pikë**
- përdor shembuj dhe mbështetet në argumente bindëse për përgjigjen e dhënë - **1 pikë**

Kriteri III: Stili dhe origjinaliteti **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi: përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të qartë për atë që do të shprehë;

- shprehet me një gjuhë të saktë dhe pa huazime (nuk mund të shprehte me terma të tilla si: kontestim, konfliktualitet etj., stil origjinal. - **1 pikë**
- përdorë saktë dhe në vendin e duhur termat historik; - **1 pikë**

Kriteri IV: Aspekti kronologjik **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- Ndjek në mënyrë kronologjike ngjarjet që lidhen me tematikën e esesë; Strukturon esenë në mënyrë të tillë, për të qenë besnik i aspektit kronologjik. – **1 pikë**
- Përpiqet të përshtatë idetë e tij me kronologjinë e ngjarjeve, duke shmangur një kronikë të thjeshtë historike, por duke e përdorur kronologjinë në funksion të argumenteve të esesë - **1 pikë**